

Saranda e munguar është testamenti i gjurmëve të ngjizura nga ngjarjet dhe arsyt kryesore që i dhanë fillim ekzistencës, vazhdimësisë dhe transformimit të qytetit. Ky sekret i shpirtit të qytetit, thesar ende i fshehur, nuk serviret thjesht si nostalgji, por si energji pozitive transformuese dhe si instrument dizajni nga ku mund të marrin jetë vepra të reja drejt një qyteti më të dëshiruar.

Qyteti i munguar është rilexim i historisë së qytetit dhe vendmbajtësit të tij gjeografik, me ndjeshmërinë bashkëkohore për të rikuperuar urbanen dhe natyrën në një kohë kur duket se qytetet tona kanë humbur orientimin; është një sinjal për të kuptuar se si fusha e kërkimeve me fokus historinë e qytetit mund të bëhet aktive dhe pjesëmarrëse për të ndërtuar vlera të së ardhmes; përpjekje për të kuptuar se si zgjidhje në të kaluarën mund të ndikojnë të tashmen dhe të ardhmen.

Diferenca midis qytetit real e të përditshëm dhe atij imagjinar, apo midis gjendjes si jemi dhe si duam të jemi, krijon qytetin e munguar. Kjo është hapësira e kërkimit të cilën përpiqemi të eksplorojmë e të risjellim në serinë e qyteteve të munguara. Saranda, si vazhdim i kësaj serie, është rasti i dytë që trajtojmë në këndvështrimin e marrëdhënieve që krijon qyteti me projektet dhe vizionet e hartuara për të, me energjitë mendore, intelektuale, trashëgiminë e tyre, si edhe ndikimin që ato kanë në të ardhmen e qytetit.

SARANDA


QYTETI I MUNGUAR

Sotir Dhamo

Gjergj Thomai

Besnik Aliaj

SARANDA
QYTETI I MUNGUAR





SERIA E PUBLIKIMEVE SHKENCORE TË UNIVERSITETIT POLIS
POLIS_PRESS

SARANDA - QYTETI I MUNGUAR

Autorë: Dr. Doc. SOTIR DHAMO, Dr. GJERGJ THOMAJ, Prof. Dr. BESNIK ALIAJ

Redaktor letrare: Arlon Liko

Përgatiti për botim dhe dizajn: Kristiana Meço

Kopertina: Dr. Sonia Jojic, Kristiana Meço

Shtypur nga: Shtypshkronja PEGI

Reçensentë: Prof. Valerio Perna, Prof. Fabrizio Aimar

Këshillimi: Dr. Dritan Shutina, Dr. Rudina Toto

Përpunimi grafik dhe analitik i materialeve të Arkivës është kryer nga:

Kristiana Meço, Avril Meshi, Xhesian Çela, Tea Murraj, Eni Gjoka, Sara Dulaj

Editorë: Besnik Aliaj, Sotir Dhama, Dritan Shutina

Botues: POLIS_PRESS

Burimet e materialeve grafike dhe fotografike janë nga Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit si (AQTN) edhe nga kërkimet analitike të autorëve dhe të Universitetit POLIS.

Ky botim u mundësua nga bashkëpunimi institucional rregulluar me marrveshje mes Universitetit POLIS dhe MIE (Ministria e Infrastruktures dhe Energjise). Libri është pjesë e aktivitetit të përbashkët kërkimor të Universitetit POLIS dhe Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit që zhvillohet në kuadër të këtij bashkëpunimi.

Tiranë, Maj 2022

© copyright Universiteti POLIS

Shkolla Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Politikave të Zhvillimit

Ky libër u financua nga Polis_PRESS, Universiteti POLIS

ISBN 978-9928-347-06-0



POLIS_Press

PËRMBAJTJA

HYRJE	8
RIKUJTESË – DY FJALË MBI “QYTETIN E MUNGUAR”	
KAPITULLI I	14
FILLESAT DHE MOMENTET KYÇE NË ZHVILLIMIN E QYTETIT	
1.1 Nga Onchesmos te Dyzet Shenjtorët, Porto-Eda dhe Saranda	
1.2 Saranda “Locus Solus” - vendi, ngjarja dhe shenja	
KAPITULLI II	34
PLANET E PERIUDHËS 1925 -1940	
Plani rregullues i vitit 1925	
2.2 Plani rregullues “Porto Eda”, 1940	
2.2.1 Konteksti intitucional dhe profesional i fazës kur u hartua plani	
2.2.2 Saranda para planit rregullues të vitit 1940	
2.2.3 Idetë kryesore të planit “Porto-Eda”	
2.2.4 Rregullorja e planit rregullues të “Porto-Eda”	
2.3 Aspekte të qytetit të munguar	
2.4 Fjalor i kohës	
KAPITULLI III	100
PLANET RREGULLUESE TË SARANDËS, TË HARTUARA MIDIS VITEVE 1958-1965	
3.1 Plani i pëgjithshëm rregullues i hartuar midis viteve 1958-1960	

- 3.1.1 Konteksti i përgjithshëm i fazës kur u hartua plani
- 3.1.2 Situata profesionale
- 3.1.3 Turizmi në kushtet e vetëizolimit
- 3.1.4 Saranda para-planit rregullues të vitit 1958-1960
- 3.1.5 Idetë dhe principet kryesore të planit të vitit 1958- 1960
- 3.1.6 Konkluzione për planin e hartuar midis viteve 1958-1960
- 3.2 Projekti i planit rregullues të Plazhit Sarandë
- 3.3 Hotel Turizmi Sarandë
- 3.4 Spitali dhe poliklinika e spitalit
- 3.5 Aspekte të qytetit të munguar

KAPITULLI IV

200

QENDRA DHE SHËTITORJA BREGDETARE E QYTETIT TË SARANDËS
(1974-1976)

- 4.1 Mbi projekt-Idenë e hyrjes, qendrës dhe shëtitores së Sarandës
- 4.2 Kinoteatri Sarandë

KAPITULLI V

228

PLANET RREGULLUESE TË SARANDËS DHE PROJEKTET E HARTUARA
NË VITET 1980-1990

- 5.1 Plani Rregullues i vitit 1984
 - 5.1.1 Konteksti i përgjithshëm i fazës kur u hartua plani
 - 5.1.2 Idetë dhe principet kryesore të planit rregullues të viteve 1981-1984
 - 5.1.3 Konkluzione në lidhje me këtë plan
- 5.2 Studimi Urbanistik Pjesor i Kodrës së Limionit
- 5.3 Përtej Sarandës
 - 5.3.1 Plani Rregullues Ksamil
 - 5.3.2 Studimi i fshatrave në territorin e rrethit të Sarandës
- 5.4 Shtëpia e pushimit të punëtorëve në Sarandë
- 5.5 Komiteti i Partisë Sarandë
- 5.6 Aspekte të qytetit të munguar

PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME

HYRJE

Rikujtesë – dy fjalë mbi “qytetin e munguar”

“Saranda e munguar” është vazhdim i serisë së “qyteteve të manguara”. Pas Tiranës, Saranda është rasti i dytë që trajtojmë në këndvështrimin e marrëdhënieve që qyteti krijon me projektet dhe vizionet e hartuara për të dhe ndikimin e tyre në të ardhmen e tij. Projektet e analizuara në këtë libër, që mbulojnë harkun kohor midis viteve 1925 dhe 1990, të realizuara apo jo, janë pjesë e rëndësishme e energjisë mendore që ka formësuar apo ndikuar zhvillimin e Sarandës së sotme dhe në këtë aspekt, vlejnë të rinxirren në dritë.

Ky proces bëhet edhe më i vlefshëm kur distanca kohore nga lidhjet politike dhe strukturat administrative të cilat kanë nxitur, financuar apo propaganduar këto projekte është e konsiderueshme. Ndër të tjera, ky reflektim shërben për të rivlerësuar edhe vetë efikasitetin e instrumenteve të planifikimit, ndikimin e tyre real në zhvillimin e qyteteve, si dhe raportin me spontanitetin dhe “liritë” njerëzore në zhvillimin e vendbanimeve. Në analizë të fundit, ky reflektim synon të sjellë përgjigje alternative edhe për shumë pikëpyetje që shtrohen sot në lidhje me praktikën e planifikimit të qyteteve. Sikurse çdo qytet, edhe Saranda është fryt sa i vizioneve dhe imagjinatës së shprehur në mënyrë racionale në plane e projekte, aq edhe i spontanitetit apo i veprimtarive njerëzore, nxitëse apo frenuese ndaj këtyre vizioneve, që në fund mishërohen te qyteti real. Pikërisht kjo diferencë midis qytetit real e të përditshëm dhe atij imagjinar, apo midis gjendjes si jemi dhe si duam të jemi, krijon “qytetin e munguar”. Kjo është hapësira e kërkimit të cilën përpiqemi të eksplorojmë e të risjellim në serinë e qyteteve të manguara.

Vlen të theksojmë se përdorimi i termit “e munguar” nuk nënkupton thjesht mungesën e një prezence fizike, por sikurse thotë Eisenman, ajo mund të përfaqësojë një formë tjetër të memories (2006, f. 40), e cila mund të rishfaqet përsëri për të influencuar të ardhmen. Kështu, në këtë libër na

intereson më shumë ajo formë e memories që Eisenman, duke iu referuar Derrida-së, e quan “gjurmë” (2006, f. 40), e kuptuar kjo si prezenca e një mungese. Sipas këtij koncepti, qyteti dhe urbanizmi shkojnë drejt të kuptuarit si një palimpsest i shumëfishtë, i cili krijohet nga një rrjet memoriesh apo gjurmësh që gdhendin e tregojnë ngjarje, që mbivendosin fakte dhe fiksione (2006, f. 40) që shpjegojnë vetë qytetin.

Në këtë kuptim, qyteti i munguar mund të kthehet edhe në një instrument dizajni e planifikimi me vlerë. Sikurse kemi theksuar në rastin e Tiranës, ashtu edhe në rastin e Sarandës, logjika e “qytetit të munguar” nuk nënkupton një qarje nostalgjike, përkundrazi, synon të kthehet në forcë nxitëse drejt një qyteti më të dëshiruar. Kështu, ndër të tjera, qyteti i munguar synon të nxjerrë në pah edhe vlera të cilat kanë të bëjnë me arsyet e ekzistencës së vet qytetit dhe që koha i ka lënë në harresë, por që mund të përbëjnë vlerat kryesore mbi të cilat të hartohet një strategji e ringjalljes së qyteteve. Në këtë aspekt, logjika e “qytetit të munguar” transformohet në energji pozitive të reflektimit mbi projekte të realizuara, të realizuara pjesërisht, apo thjesht të propozuara dhe të paardhura asnjëherë në jetë. Kjo mënyrë trajtimi, e cila nisët nga ajo që ka ndodhur në qytet në fushën e zhvillimeve urbane, të para këto në këndvështrimin se çfarë mund të kishte ndodhur, ndihmon të kuptuarit e evolucionit të qytetit, duke nxjerrë në pah arsye të padukshme apo të padeklaruara për kohën kur kanë ndodhur. Sikurse kemi theksuar edhe në rastin e Tiranës, këto prezenca të munguara (ide mbi qytetin) kthehen shpesh në frustrime pozitive, të cilat në një moment të caktuar mund të dalin në dritë e të bëhen të prekshme, por natyrisht duke u përkthyer në kontekstin e ndryshuar të qytetit.

Struktura e përgjithshme e materialit ndjek një rend kronologjik, i cili bazohet

në periudhat kur janë hartuar planet dhe projektet kryesore që kanë ndikuar formësimin dhe zhvillimin e qytetit e të rrethinave të Sarandës. Këto plane zënë fill nga periudha e Mbretit Zog, vazhdojnë me periudhën e fashizmit dhe vijnë deri në fund të periudhës së diktaturës, në harkun kohor midis viteve 1925-1990. Për ta parë Sarandën në vazhdimësinë e lidhjeve hapësirë-kohë, libri paraprihet nga një sintezë e arsyeve dhe ngjarjeve kryesore që lidhen me fillesat, ekzistencën dhe vazhdimësinë e vetë qytetit. Këto arsye, të lexuara me kujdes, ngjizën thelbin që duhet të përbënte/përbëjë çdo ndërhyrje në qytetin e Sarandës. Bazuar në studimet e historianëve dhe arkeologëve, detyra jonë përmes këtij kapitulli ka qenë të tregojmë se, gradualisht, ky thelb ka ardhur duke u tretur e harruar, si edhe potencialin e rikonsiderimit të tij. Madje, qyteti i munguar zë fill tek kjo harresë! Në materialet arkivore të shqyrtuara sipas këtyre periudhave, bie në sy qëndrimi i ndryshëm në lidhje me përmbajtjen e planeve dhe mënyrën e detajimit të tyre në shkallë dhe teknika të ndryshme, apo në madhësinë e territoreve që ato përfshinin; horizontet e parashikimeve të planeve dhe presupozimin apo besimin në saktësinë e parashikimeve të tyre, që lidhej me të kuptuarit e qytetit dhe planifikimit të tyre si një proces linear e jo kompleks, si një proces që kishte të bënte thjesht me dizajnin e tyre dhe jo me strategjinë për menaxhimin e projekteve.

Në lidhje me sa më sipër, në kapitullin e parë tregohet një historik i shkurtër i territorit ku u shënuan ngjarjet dhe fillesat e para të asaj çka do të ishte më vonë qyteti i Sarandës. Historia, e cila bazohet në autorë historianë e studiues të cituar në tekst, është treguar në paralel me ndryshimin e emrave të Sarandës që shprehin njëkohësisht kontekstin historik e politik të shtratit të transformimeve të qytetit. Në kapitullin e dytë përshkruhen tentativat e para për rregullimin e qytetit të Sarandës përmes disa operacioneve modeste, por

domethënëse për kohën. Këto operacione janë përmbledhur në planimetritë e vitit 1925, të hartuara gjatë periudhës së Mbretit Zog, si edhe në planimetritë e vitit 1940, të hartuara gjatë periudhës së pushtimit fashist, kur shënohen edhe tentativat e para për të organizuar qytetin, duke përfshirë në procesin e dizajnit si elementet e mbërritura nga historia (p.sh. muret e lashta), ashtu edhe ato që nevojiteshin për zhvillimin dhe shtrirjen e ardhshme të qytetit.

Në kapitullin e tretë përshkruhen përpjekjet pas Luftës së Dytë Botërore, gjatë periudhës së diktaturës, të mishëruara në planin e hartuar midis viteve 1958-1960, për t'i dhënë Sarandës strukturën e një qyteti me ndarje të qartë zonale (porti, turizmi, banimi) dhe infrastrukturë rrugore, gjë që nuk kishte qenë e mundur të krijohej për shkak të realizimeve të pakta të planeve të mëparshme. Si pjesë e këtij kapitulli analizohen edhe variantet e shumta të projekteve për plazhin e Sarandës të fillim viteve '60. Këto projekte të hartuara në kuadrin e kufizimeve të ashpra dogmatike dhe ideologjike, edhe pse paraqiteshin mjaft të rezervuara e modeste në pretendimet e tyre, nuk mundën të realizoheshin asnjëherë. Në kapitullin e katërt përshkruhet projekti për hyrjen, qendrën dhe shëtitoren bregdetare të qytetit. Propozimet e këtij projekti mbartin përpjekjen për të kthyer Sarandën në një pol turistik të bregut të detit Jon dhe në një qendër të rëndësishme administrative dhe urbane. Në kapitullin e pestë prezantohet procesi për hartimin e Planit të Përgjithshëm Rregullues të hartuar midis viteve 1982-1984. Ky plan përpiqet ta konceptojë Sarandën jo vetëm si një qendër urbane në vetvete, por si gravitacion territorial i ekonomive bujqësore dhe turistike përreth saj. Projektet e disa prej këtyre vendbanimeve, pjesë të këtij gravitacioni, si Ksamili dhe fshatra të tjerë, janë paraqitur e trajtuar po ashtu si pjesë e këtij kapitulli. Gjithashtu, në disa nga këto kapituj janë analizuar edhe veprat arkitektonike kryesore, pjesë e imazhit të Sarandës, si hotel turizmi, kinoteatri, spitali, shtëpia e pushimit etj.

Kapitujt shtjellohen rreth disa çështjeve kryesore si p.sh., konteksti historik kur u hartua plani, organet vendimmarrëse, autorët kryesorë, parimet, vizionet dhe konceptet e përgjithshme të planit, shifra sintetike ku mishëroheshin parashikimet e planit, skemat e zhvillimit hapësinor dhe rrjetat kryesore rrugore e të shërbimit, drejtimit kryesorë të zhvillimit, struktura e qytetit dhe propozimet për transformim etj. Në varësi të të dhënave të materialeve arkivore, këto çështje marrin rëndësi të ndryshme sipas kapitujve. Nëntitujt e kapitujve karakterizojnë operacionet kyçe të nxitura nga çdo plan.

“Copëza nga qyteti i munguar” përmbajnë disa nga “frustrimet” pozitive si pjesë e “qytetit imagjinar”: propozime të pazbatuara, apo elemente (natyrale apo të ndërtuara) të “humbura” të qytetit. Në fund të kapitujve që trajtojnë planet e periudhës së Mbretit Zog apo të fashizmit janë vënë në dukje edhe shprehje të gjuhës profesionale nga fjalori tipik i kohës. Kjo ndihmon jo vetëm të kuptojmë se si ka evoluar gjuha, por mbi të gjitha të kuptojmë origjinën e huazimit dhe evoluimin të vetë koncepteve profesionale. Në tabelat hyrëse që përmbledhin të dhënat për hartimin, autoritetet dhe komisionet miratuese të planit, lexuesi mund të njihet me institucionet kryesore të kohës që ndiqnin procesin e planifikimit urban, projektimit arkitektonik dhe ndërtimit. Në fund të çdo kapitulli janë shënuar materialet dhe relacionet arkivore bazë, si dhe lista bibliografike e referencave teorike të cituara në tekst. Edhe pse materiali ndjek rrjedhën kronologjike, libri nuk është thjesht një histori urbanistike e qytetit të Sarandës, apo një radhitje e planeve dhe projekteve në rrafshin Teknik. Libri synon të sjellë një logjikë e cila vlerëson jo vetëm trashëgiminë e ndërtuar, por edhe atë të mendimeve për zhvillimin e qytetit të para në kontekstin historik të kohës dhe synon të krijojë një kulturë të re studimi dhe analize në raport me këtë çështje edhe në Shqipëri.

Gjejmë këtu rastin të ritheksojmë një tezë, bindja për të cilën na forcohet pas çdo kërkimi të ngjashëm. Ndryshe nga sa mendohet rëndom se qyteteve tona u mungojnë vizionet, planet apo projektet, e vërteta qëndron ndryshe. Ndërsa qytetet tona mbartin një bagazh të pasur projektesh që përfaqëson një energji mendore ende për t'u eksploruar, ajo çfarë ka munguar në të vërtetë ka qenë të vepruarit, ose faza e administrimit të këtyre projekteve. Ky apatizëm buron nga paaftësia e kapaciteteve administrative, të cilat shpesh janë nën nivelin e qytetarëve të zakonshëm, si edhe nga kultivimi i kulturës së ndalimit dhe frikës së gabimit që trashëgohet në mentalitetin autoritarist të administratës shqiptare. Ky problem mbetet aktual, gjë për të cilën materiali në vazhdim fton të reflektojmë.

Së fundmi, por shumë e rëndësishme, në të dyja volumet e qyteteve të munguara të botuar deri tani, jemi përpjekur të shlyejmë edhe një detyrim moral në raport me emra të "heshtur" të planifikimit dhe arkitekturës Shqiptare. Kështu, ndër të tjera, ky libër shërben për të sjellë në kujtesë emrat e projektuesve shqiptarë e të huaj, por me kontribute në formësimin e qyteteve pavarësisht kushteve të vështira në të cilat kanë vepruar, si edhe për të analizuar me gjakftohtësi projektet e tyre pavarësisht shkallës së suksesit apo mos-suksesit. Kjo është edhe një thirrje për të hequr dorë nga anonimiteti i projekteve të shkallës urbane.

Për të bërë të mundur këtë kërkim në mënyrë specifike i jemi referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nga Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (AQTN) mbi bazën e një projekti bashkëpunimi midis këtij arkivi dhe Universitetit POLIS.

KAPITULLI I

FILLESAT DHE MOMENTET KYÇE NË ZHVILLIMIN E QYTETIT

1.1 Nga Onchesmos te Dyzet Shenjtorët, Porto-Eda dhe Saranda



Historia e treguar në këtë kapitull ndihmon të kuptojmë ngjarjet dhe shenjat kryesore të territorit, që kanë shënuar fillesat e vendbanimit, si edhe momentet kyçe në zhvillimin e qytetit, e që e vendosin Sarandën në vazhdimësinë e lidhjeve hapësirë-kohë. Kështu, historia e Sarandës dhe territorit përreth saj është treguar në funksion të qëllimit të këtij libri, pa pretenduar të jetë një histori e detajuar e qytetit. Momentet kyçe të historisë ndjekin emrat e ndryshëm që ka marrë qyteti në raport me ngjarjet kryesore të lidhura me to. Materiali në vijim i referohet kryesisht dokumenteve të shkruara nga Hodges (2007, 2011), Ceka (2002, 2006), si edhe autorëve të tjerë, të cituar në tekst.

Emri i parë i Sarandës, *Onchesmos*, sipas Hodges (2007, f. 12) vjen nga trojani *Anchises*, nga bashkimi i të cilit me perëndeshën *Aphrodite*, në malin Ida, lindi *Aeneas*. Ky i fundit, sipas tregimeve, iku nga Troja gjatë udhëtimit të refugjatëve Trojanë drejt Mesdheut Qendror me djalin e tij *Ascanius-in* duke mbajtur mbi shpinë babanë, *Anchises-in*, e plagosur. Kjo skenë shfaqet edhe në shumë imazhe artistike (fig. 1.1). *Dionysius-i i Halicarnasus-it* (1.51.1-2, te Hodges 2007, f. 12-13) e quan *Onchesmos-in* portin e *Anchises-it* dhe tregon se si trojanët, duke lundruar nga *Buthrotum-i* përgjatë bregut, arritën në një vend që quhej porti i *Anchises-it* dhe aty i dedikuan një tempull *Aphrodite-s*.

Emri *Onchesmus* përmendet edhe nga autorë të tjerë, si Cicero në korrespondencën e tij me Titus Pomponius Atticus (*Letters to Atticus* 7.2.1, te Hodges 2007, f. 13); dhe Strabo në Gjeografinë e tij (7.7.5, te Hodges 2007, f. 13) të shkruar në periudhën Augustan-e, duke nënkuptuar se ishte një port me akses te *Phoenice*. Po ashtu, edhe sipas Cekës (2002 f. 14), Onkezmi përmendet për herë të parë nga Straboni në shek. I, BC, kur shërbente si skelë e Foinikes (fig. 1.2).

Sipas Cekës, nga shek. II AD u zhvillua si qytet më vete dhe në shek. IV AD u fortifikua. Dallohen muret e kështjellës që ka patur perimetër 850 m, një brinjë e së cilës mbështetej në bregdet dhe sipërfaqe 5 ha (fig. 1.3; 1.4). Si pasojë e ndryshimit të vijës bregdetare, muri jugor u shkatërrua dhe nga ky fragment sot ruhen rrënojat e një kulle që kishte hyrje në formë harku me tulla. Në faqet veriore, nga ku priteshin edhe sulmet e mundshme, muret ishin të përforcuara edhe me kulla katërkëndëshe, poligonale dhe rrethore

(Ceka 2002, f. 14, 15). Nga rrënojat e mureve rrethuese të qytetit, pjesë të të cilave dalin edhe në shëtitoren bregdetare, kuptohet se Saranda ka qenë nën Perandorinë Romake deri në shek. IV AD. Hierokli e përmend Onkezmin në gjysmën e parë të shek. VI AD, si një nga qytetet kryesore të provincës së Epirit të Vjetër, duke qenë njëkohësisht edhe qendër peshkopate (Ceka 2006, f. 11). Me këtë periudhë lidhen edhe një numër kishash paleokristiane.

Bazilika trenefshe, e adaptuar brenda një ndërtese paraekzistuese, ndodhet brenda mureve të kështjellës dhe në perëndim të sheshit kryesor të sotëm. Kjo bazilikë dhe mozaikët e dyshemeve të saj që janë nga monumentet arkitektonike të periudhës antike të vonë të ruajtura më mirë, mendohet se ka shërbyer si sinagogë, të paktën për një kohë (fig. 1.5). Gërmimet kanë treguar se bazilika është ngritur mbi një ndërtesë më të hershme. Po ashtu, një ndërtim tjetër kulti i shek. V AD është gjetur pranë postës. Ky rol i qytetit ruhet deri nga fundi i shek. VI AD, kur dyndjet sllave e shkatërruan (Ceka 2002, . 15).

Identiteti i mëtejshëm i Sarandës lidhet me manastirin e Dyzet Shenjtorëve të Sebaste-s i ndërtuar nga fundi i shek. V AD ose fillimi i shek. të VI AD në kodrën mbi qytetin e Sarandës (fig. 1.6). Dyzet Shenjtorët apo “martirët e Sebastës”, mendohet të kenë qenë ushtarë të legjionit të dymbëdhjetë romak, të cilët nuk pranuan të hiqnin dorë nga besimi i tyre i krishterë. Për këtë arsye, ata u torturuan dhe më pas u vranë me urdhër të perandorit romak *Licinius-it* në vitin 320 AD (Pettifer Julia dhe Pettifer James 2007, f. 22-23). Kulti i dyzet shenjtorëve u përhap sidomos në Mesdheun Lindor. Sipas Hodges, referenca e parë e përdorimit të këtij emri shfaqet në kronikat e abatit kryqtar, Benedict-i i Peterborough-ut dhe daton në vitin 1191. Ai përshkruan rrënojat e *Onchesmos-it si Sancta Karentet* (Stubbs 1867: 205, te Hodges 2007, f. 14). Mund të supozojmë kështu që ky emër filloi të përdorej midis fundit të antikitetit deri në Mesjetën e Mesme. Kisha e Dyzet Shenjtorëve, qendër e rëndësishme pelegrinazhi, me dizajn unik dhe madhësi domethënëse ishte një shenjë qartësisht e dallueshme mbi det për të tërhequr si besimtarët kristianë të brigjeve të Adriatikut, ashtu edhe ata nga brendësia e Ballkanit. Sipas Cekës, kisha kishte një gjatësi prej 50 m, me një hyrje që kalonte përmes



Figura 1.1 Aeneas gjatë udhëtimit të refugjatëve trojanë drejt Mesdheut Qendror me djalin e tij Ascanius-in, duke mbajtur mbi shpinë babanë, Anchises-in, e plagosur




Figura 1.2 Onkezmi, territori, shenjat. Udhëtimi i Aeneas nga Troja në Romë sipas Virgjilit




Figura 1.3 Rrënojat e mureve rrethuese të qytetit; fortifikimet e shek. IV AD me sipërfaqe 5 ha, njëra brinjë mbështetëj në bregdet (informacioni i skemës nga Hodges, 2007)



Figura 1.4 *Fragment Muri, 2005*




Figura 1.5 *Kisha Sinangoga*



Figura 1.6 *Manastiri i Dyzet Shenjtorëve të Sebaste-s*

Eksonarteksit dhe *Narteksit*. Kjo hapësirë unike ndahej në shtatë apsida. Kisha e Dyzet Shenjtorëve kishte edhe kriptën të ndërtuar në shek. VI AD dhe që shërbente si varrezë, me hyrje në anën jugore (2002, f. 17).

Në librin e Qendrës së Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë, (2013, f. 231) citohet Kozma Thesprotos-i, i cili përshkruan Kishën e Dyzetë Shenjtorëve ashtu sikurse e ka parë në vitin 1830: “mbi kodër... rrënojat e një tempulli të madh kristian, me një strukturë të madhe të nëndheshme, të nënndara në shumë kisha të vogla ...”; po sipas këtij burimi, i pari që skicoi një plan skematik të kishës dhe që lidhi kohën e ndërtimit të kishës me qytetin e fortifikuar të Anchiasmos-it¹ ishte W. M. Leake. Sikurse thekson edhe Hodges te “Butrinti i përjetshëm”, me planin e saj jo të zakonshëm, kjo kishë ka qenë e pashoqe dhe gjen paralele te *triclina-t* shumëkungëshe të antikitetit të vonë, si hollit i banketeve në Pallatin e Lausit në Kostandinopojë; ndërsa disa tipare të tjera gjenden në *martyria-t* e periudhës së hershme të krishterimit (Hodges 2006, f. 219).

Sipas Hodges, bazilika e themeluar rreth viteve 500 AD shërbehej nga një manastir, i cili vazhdoi të ekzistonte deri në shek. XIV dhe XV, kur fatet e këtij manastiri ndryshuan për shkak të pushtimit otoman. Ndërtimet e manastirit, sikurse edhe dhomat për pritjen e pelegrinëve, filluan të rrënohen, ndërsa kisha vazhdoi të përdorej deri në mes të shek. XIX nën kujdesin e një komuniteti të vogël murgjish. Më pas, bazilika u braktis dhe u rrënuar derisa ndërtesa u shkatërrua nga artilleria gjermane në vitin 1944. Pavarësisht shkatërrimit, kripta është e ruajtur mjaft mirë. Ajo përbëhet nga një labirinth dhomash, holle të mbuluara me qemer, korridore dhe kapela, të cilat ndodhen poshtë narteksit dhe krahut jug-lindor të kishës. Nga fundi i viteve '50, kodra u shpall zonë ushtarake dhe ishte e paaksesueshme deri në vitin 1997 (Hodges 2007, f. 30-32).

Fundin e lulëzimit gjatë periudhës së antikitetit të vonë, Saranda e pati rreth fundshekullit VI ose fillimshekullit VII, që mund të lidhet edhe me sulmin sllav në brigjet epirote, gjë që duket edhe nga gjurmët e zjarreve. Sipas Hodges (f.

¹Sikurse vihet re, Anchiasmos shfaqet në këtë material me emra të ndryshëm (Anchesmos, Onkezmi etj.) Në secilin rast është ruajtur emri original sipas burimit të referencës.

Përfundime të përgjithshme

Në këtë libër trajtuam fillimisht një sintezë të ngjarjeve dhe arsyeve kryesore që lidhen me fillesat, ekzistencën dhe vazhdimësinë e qytetit të Sarandës; më tej trajtuam përpjekjet e administratave të ndryshme nga mesi i viteve '20 deri në fund të viteve '80 për të krijuar, transformuar dhe konsoliduar qytetin. Këto përpjekje i pamë në këndvështrimin e “qytetit të munguar”, ose diferencës midis qytetit real dhe atij të shprehur në projekte e mendime për qytetin. Në këtë këndvështrim, qyteti i munguar nuk serviret si një qarje nostalgjike, por si energji pozitive transformuese dhe më e rëndësishmja si një instrument dizajni drejt një qyteti më të dëshiruar.

Një nga mesazhet më të rëndësishme që jemi përpjekur të japim në këtë libër është se qyteti i munguar zë fill te harresa e arsyeve dhe ngjarjeve kryesore që lidhen me fillesat, ekzistencën dhe vazhdimësinë e vetë qytetit, arsye këto të shpjeguara në kapitullin e parë dhe të përmendura herë pas here në libër. Ritheksojmë se janë pikërisht këto arsye që do të duhej të ngjizin thelbin e çdo ndërhyrjeje në qytetin e Sarandës. Sikurse përshkruhet në kapituj, këto arsye erdhën duke u tretur e harruar gradualisht, ose në rastin më të mirë, të pranoheshin vetëm me fjalë. Kjo logjikë shkon përtej Sarandës, pasi ka karakterizuar të gjitha ndërhyrjet urbane në qytetet shqiptare, sidomos ato të Pasluftës së Dytë Botërore.

Sikurse është përmendur edhe në fillim, përshkrimi në libër ndjek një rend kronologjik sipas periudhave kur janë hartuar planet duke filluar nga periudha e Mbretit Zog, e ndjekur nga periudha e fashizmit dhe periudha e Pasluftës së Dytë Botërore e deri në fund të rënies së regjimit diktatorial, duke mbuluar kështu një hark kohor midis viteve 1925-1990.

Planet e para, ato të periudhës së Mbretit Zog, mbulojnë territore mjaft të kufizuara të qytetit. Gjithsesi, ato na ndihmojnë për të kuptuar atë çka ishte thelbi i qytetit dhe i këtij plani në atë kohë, zona brenda mureve të vjetra, e cila sot është e humbur krejtësisht. Plan i periudhës së fashizmit synoi të krijonte një qytet me matricë Evropiane, një rrjet me njësi urbane të racionalizuara, që njëkohësisht ndiqnin variacionet e terrenit dhe që krijoheshin nga përdorimi

i tipologjive në shkallën që i përshtatej terrenit dhe qytetit të asaj kohe. Edhe pse veproi për një kohë shumë të shkurtër dhe pati realizime të pakta, ky plan ndikoi mënyrën e të konceptuarit të qytetit në një shkallë më të madhe se plani i mëparshëm, shkallë të cilën arriti deri në vitet '90. Ky plan ndikoi sidomos rrjetin rrugor dhe idenë e shkallareve, por nuk arriti të ndikojë krijimin e qytetit që gjenerohet nga raportet e ndërsjella tipologji-morfologji.

Planet që ndoqën gjatë periudhës së komunizmit, ai i vitit 1958-1960 dhe ai i vitit 1984, ishin pothuajse shëmbëlltira të planit të mëparshëm, por me cilësi “tretëse” sa i takon raporteve tipologji-morfologji, gjë që duke te shkëputja e ndërtesave nga sistemi i komunikimit dhe mbi të gjitha te mungesa e raporteve që ndërtesat krijojnë brenda njësive urbane dhe me vazhdimësinë e qytetit.

Këto plane dallohen edhe nga një shprehje urbane tepër e “ndrojtur” ose e vetëpërmbajtur, edhe pse qyteti në atë kohë po rritej (kapacitete të kufizuara banimi, shërbime tregtare të numëruara, kabina plazhi tepër të kufizuara etj.), gjë që vinte nga kufizimet ideologjike të vet sistemit. Megjithatë, këto plane e “garantuan” Sarandën deri në fund të viteve '80, si një qytet të vogël që do të arrinte maksimumi rreth 20 mijë banorë. Në përgjigje të kësaj strategjie të të bërit qytet, u ruajtën me fanatizëm principe shumë të rëndësishme, si ndërtimet e shkallëzuara sipas amfiteatrit natyral, të shkëputura e në shkallë të vogël për t'ju përgjigjur terrenit, të hapura dhe të ekspozuara ndaj dritës dhe nga deti. Në këtë kuadër, përpjekje të konsiderueshme paraqet projekti i kodrës së Limionit, si nga pikëpamja urbanistike, ashtu edhe e zgjidhjeve arkitektonike. Në rastin e këtij projekti duket se organet shtetërore të kohës kishin dhënë miratimin për të realizuar zgjidhje projektesh të veçanta. Po ashtu, përpjekja për të realizuar të ashtuquajturat plane rregulluese për të gjitha fshatrat e Rrethit të Sarandës dhe për të mbajtur e ngritur shërbimet e duhura në secilin prej këtyre fshatrave (edhe pse me standard e cilësi tepër modeste), është mjaft e lavdërueshme në drejtim të shpërndarjes së popullsisë në raport me burimet territoriale.

Por kombinimi i kësaj politike me detyrimin për t'u zhvendosur dhe për të banuar në këto vendbanime jashtë zgjedhjeve dhe dëshirës personale të njerëzve, natyrisht që dha impaktin negativ të braktisjes së tyre menjëherë

pas rënies së regjimit. Planet e hartuara gjatë periudhës së komunizmit patën një ndikim të gjatë, për gati katër dekada e gjysmë dhe pavarësisht cilësisë së realizimit si në shkallën arkitektonike ashtu edhe atë urbane, arritën të përcjellin deri në fillim të viteve '90 një Sarandë dhe një rajon gati steril, me burime të pashfrytëzuara për turizëm e bujqësi, të pastruar nga mbingarkesat e tepërta, por gati të “vdekur” nga pikëpamja e aktiviteteve njerëzore dhe jetësimit të potencialeve të vërteta që mbartte qyteti dhe rajoni, e mbi të gjitha me historinë e saj ende të fshehur e të padeklaruar.

Impianti urban i qytetit të sotëm (jo vetëm rrjeti rrugor, por gjithë marrëdhëniet e ndërsjella brenda trupit urban), sidomos ai i qytetit të pasviteve '90, ngjan pak ose aspak me atë çka janë përpjekur të arrijnë planet e analizuara në këtë libër. Kështu, rrjedha e përshkruar në libër mund të na ndihmojë edhe për të reflektuar e për të kuptuar efikasitetin e vetë instrumentit plan, si edhe ndikimin e tij në zhvillimin e qyteteve.

Në lidhje me këtë mund të themi se deri në vitet '90, Saranda (edhe pse kishte kaluar vijat kufizuese të ndërtimeve, sikurse është përmendur në material) përgjithësisht ndoqi zhvillimin sipas planeve në fuqi. Në kontekstin për të cilin flasim, të një shoqërie tërësisht të kontrolluar nga lart, raportet midis planit dhe qytetit ishin të thjeshtëzuara. Në këtë aspekt edhe vet plani kishte më shumë gjasa të kontrollohej e të ndiqej me rigozitet në çdo aspekt të tij. Fazës që përjetonte Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore, që synonte fillimisht krijimin e profilit të një vendi bujqësor të zhvilluar dhe më tej të një vendi bujqësor-industrial, duhej t'i përgjigjej edhe një politikë urbanizimi e kontrolluar që reflektohej në planet e qyteteve dhe vendbanimeve në përgjithësi. Pavarësisht problemeve, Shqipëria e kësaj periudhe po përjetonte një fazë rritjeje dhe ndryshimi, përfshi këtu edhe rritjen e popullsisë. Kështu, planet kishin për detyrë të përcaktonin shtrirjet e reja të qyteteve, duke dhënë drejtimet e zhvillimit, apo të nxisnin rritjen e qyteteve, brenda numrit të caktuar të banorëve që në mënyrë gati lineare llogaritej sipas krahëve të punës dhe shtesës natyrale të popullsisë.

Pas viteve '90, periudhë kjo që meriton të trajtohet në një volum të dytë, situata u bë më komplekse. Kjo situatë lidhej me lëvizjen e lirë të popullsisë,

fenomenin e spontanitetit dhe të informalitetit urban, interesin mbi tregun e tokave, maksimalizimin e fitimit, abuzivizmin urban etj. Instrumentet tradicionale të planifikimit ishin të pafuqishme të përballonin presionin e këtyre fenomeneve të reja që befas vepruan mbi qytet. Kështu, në mungesë të kapaciteteve administrative dhe njohurive të duhura për të trajtuar këto fenomene, qyteti po zhvillohej më shpejt se ç'mund të përgjigjej administrata me plane, pa ndjekur principet e përmendura dhe të vendosura që në planet e para të Sarandës. Kështu, në një hak kohor të shkurtër, Saranda zuri pamjen e detit dhe bllokoi shikimin e amfiteatrit natyral.

Sikurse shkruan Cervelati (1984) për Italinë e viteve '80, "... askurrë më parë si tani e ardhmja jonë nuk ka qenë më e kompromentuar brenda të tashmes; një e tashme që duket se ka humbur idenë mbi vlerat dhe kuptimin e gjenezës së vet..." (1984, f. 218) "... projektimi i lagjeve apo edhe i vet qytetit nuk respektoi realisht ambientin paraekzistues, nuk kërkoi apo zbuloi *genius loci*-n që dallon një vendbanim nga tjetri." (1984, f. 41). "Pra, t'i besojmë ende fatin e urbanizimit planit rregullues tradicional, do të thotë që në analizë të fundit të pranojmë ende një zhvillim pa kufi, pa u shqetësuar për faktin që burimet natyrore janë të kufizuara" (1984, f. 31). "Shtytjes drejt qytetit të madh, apo të konsideruarit të qytetit të madh si sinonimi i cilësisë dhe mirëqenies, duhej t'i kishte kaluar koha. Në fakt ende mbetet një aspiratë e gjithë qyteteve të vogla e të mesme. Mbajtja gjallë e ciklit të shtrirjeve urbane = shkatërrimit, përmes instrumentit-plan, është i rrënjësuar aq thellë sa është shumë e vështirë të hiqet dorë" (1984, f. 30). "Për këtë nevojitet të çrrënjësohet iluzioni se progresi është i lidhur me zhvillimin në ndërtim dhe se ky lloj zhvillimi është automatikisht civilizim" (1984, f. 218). "Në këtë epokë tranzicioni, modelet tradicionale kanë hyrë në krizë, madje edhe vetë rikuperimi urban që lipset në këtë fazë, mund të dështojë nëse shihet në sintoni me rritjen e sipërfaqeve të ndërtimit" (1984, f. 217). "... përkundrazi, rikuperimi duhet parë si rikthim i gjendjeve fillestare apo si e kundërta e pushtimit të tokave dhe si një metodë operative për qeverisjen e qyteteve" (1984, f. 207).

Shprehjet e mësipërme tingëllojnë shumë aktuale jo vetëm për Sarandën, por për të gjitha qytetet e Shqipërisë. Faza e rritjes dhe menaxhimit të qyteteve

tona me instrumente tradicionale të planit rregullues jo vetëm ka mbaruar, por po tregon të jetë gjithmonë e më e papërshtatshme dhe e korruptuar në kurriz të banorëve të qytetit. Kështu, planet, në vend që të flasin kryesisht për ekspansion urban dhe legjislacioni të shërbejë për të justifikuar rritjen e sipërfaqes së ndërtuar e të intensiteteve të ndërtimit, pra për të justifikuar shkatërrimin e qytetit me ligj, gjithmonë e më shumë duhet t'i japin vend të kuptuarit të arsyeve që lidhen me fillesat, ekzistencën dhe vazhdimësinë e vendbanimit. Mbi këtë bazë të rikuperojmë urbanen dhe natyrën, më shumë se sa të pushtojmë toka të reja.

Referenca arkivore nga AQTN dhe bibliografia për kapitullin 5 dhe përfundimet

Relacione dhe dokumente shkresore të shqyrtuara për planin rregullues të vitit 1984

Detyra e projektimit për hartimin e planit rregullues të qytetit të Sarandës
Shkresë përcjellëse e Komitetit Ekzekutiv të K. P. të Rrethit Sarandë, datë 30.06.1980, për miratimin e detyrës së projektimit të planit rregullues të qytetit të Sarandës. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të K. P. të Rrethit

Vendim nr. 23, datë 20.01.1981, mbi miratimin e detyrës së projektimit për hartimin e planit rregullues të qytetit të Sarandës. Mehmet Shehu, Këshilli i Ministrave

Parashtresë përmbledhëse mbi studimin e planit rajonal të rrethit Sarandë dhe planit rregullues të qytetit të Sarandës. V. Cicko, A. Sinani, T. Murati, L. Kosta, M. Zuma

Parashtresë teknike mbi furnizimin me ujë dhe kanalizimet e qytetit të Sarandës. L. Kosta

Vendim nr. 38, datë 17.09.1982, i Këshillit Teknik Shkencor të Ministrisë së Ndërtimit për miratimin e studimit urbanistik të planit rregullues të qytetit të Sarandës, zv. ministër i Ndërtimit, Sokrat Mosko

Shkresë përcjellëse e Komitetit Ekzekutiv të K. P. të Rrethit Sarandë drejtuar Këshillit të Ministrave për miratimin e projekt idesë së planit rregullues të qytetit të Sarandës, datë 20.04.1984. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të K. P. të Rrethit

Parashtresë për projekt idenë e ristuduar të planit rregullues të qytetit të Sarandës, datë 20.04.1984. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv të K. P. të Rrethit

Procesverbal i mbledhjes së Kryesisë së Këshillit të Ministrave mbajtur në datën 07.07.1984, për shqyrtimin e parashtresës “për projekt-idenë e ristuduar të planit rregullues të qytetit të Sarandës”. Sekretari i Përgjithshëm
Vendim nr. 164, datë 07.07.1984, mbi miratimin e planit rregullues të qytetit të Sarandës. Adil Çarçani, Këshilli i Ministrave

Dokumentet grafike të shqyrtuara për planin rregullues të vitit 1984, studimin e kodrës së Limionit, planin rregullues të Ksamilit dhe studimet e fshatrave të rrethit të Sarandës

Plani rregullues Sarandë, skema e rajonit

Plani rregullues Sarandë, projekt-ide, zgjidhja 1, shk. 1: 2000

Plani rregullues Sarandë, projekt-ide, zgjidhja 2, shk. 1: 2000

Plani rregullues Sarandë, projekt-ide, varianti përfundimtar i përgatitur për firmën miratuese të kryeministrit Adil Çarçani, shk. 1: 2000

Studim pjesor i kodrës së Limionit, Sarandë, plani i vendosjes, shk. 1: 500 (07.07.1982)

Planet e katit-tip të banesave eksperimentale nr. 3, 4, shk. 1: 50; të banesës nr. 6 (25.06.1982), shk. 1: 100 dhe të banesës nr. 7. shk. 1: 100

Plani rregullues Ksamil, projekt-ide, shk. 1: 1000

Plani rregullues Ksamil, skema e zonimit, shk. 1: 5000

Për Studimet/Planet Rregulluese të Fshatrave, shk. 1: 1000, u shqyrtua dokumentacioni teknik i Planeve Rregulluese të fshatrave Borsh, Memoraq, Ardhasov, Çerkovic, Çorraj, Ftterrë, Leshnicë e Sipërme, Sasaj, Fitorja, Leshnicë e Poshtme, Malçan, Rumanxë, Shendra, Navaricë, Dhivër, Gopik, Grazhdan, Kalacat, Karoq, Koder, Komat, Llazat, Zminec, Vagalat, Gravë, Kulluricë, Gjashtë, Lukovë, Çukë, Piqeras etj., të hartuara nga Zyra Urbanistike e Projektimit në Komitetin Ekzekutiv të K. P. të Rrethit Sarandë.

Për “Shtëpia e Pushimit të Punëtorëve” Sarandë u shqyrtua dokumentacioni teknik i projektit me stampën e Institutit të Studimeve dhe Projektive Nr. 1 në Ministrinë e Ndërtimit, të firmosur nga autorët, arkitektët D. Bijo e A. Braho, konstruktori A. Kaso, përpunuesi V. Puto, drejtori K. Kolaneci dhe shef sektori S. Bakëllbashi, më datë 15.02.1984; si edhe fotografi të kohës.

Për “Komiteti i Partisë” Sarandë u shqyrtua dokumentacioni teknik i projektit me stampën e Institutit të Studimeve dhe Projektive Nr. 1 në Ministrinë e Ndërtimit, të firmosur nga autori, arkitekti S. Bakllamaja, konstruktor D.

Sinoimeri, përpunues V. Puto, vizatues S. Topçiu, drejtori K. Kolaneci dhe shef sektori F. Pashko, më datë 30.11.86; si edhe fotografi të kohës.

Për “Shtëpia e kulturës” Ksamil u shqyrtua dokumentacioni teknik i projektit me stampën e Institutit të Studimeve dhe Projekttimeve Nr. 1 në Ministrinë e Ndërtimit, të firmosur nga autori, arkitekti P. Luarasi, konstruktore N. Filipeu, drejtori S. Mosko dhe shef sektori E. Dobi, më datë 31.07.1980; si edhe fotografi të kohës.

Referenca bibliografike për kapitullin 5

Instituti i Studimeve marksiste-leniniste pranë KQ të PPSH-së, dokumente kryesore të PPSH-së, Vëllimi VIII, (1980-1985), Shtëpia Botuese “8 Nëntori”, Tiranë. 1986

https://www.marxists.org/shqip/subjekt/dokumente-shqiptare/ppsh/dokumentet_kryesore/08/vellimi8.1.pdf

Pier Luigi Cervellati (1984) La citta post-Industriale. Il Mulino/Contemporanea8, Bologna

“Ndërtuesi” (1985), revistë teknike, organ i Ministrisë së Ndërtimit, prill-maj-qershor, nr. 2, 1985

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Dhamo, Sotir

Saranda : qyteti i munguar / Sotir Dhamo, Gjergj Thomai,
Besnik Aliaj ; red. Arlon Liko. – Tiranë : Universiteti
“Polis”, 2022

331f. : me il ;15 X 22 cm. – (Seria e Publikimeve Shkencore
të

Universitetit “Polis”)

ISBN 978-9928-347-06-0

I.Thomai, Gjergj II.Aliaj, Besnik

1.Arkitektura 2.Planifikimi i qytetit dhe ligji i rihvillinit
3.Historia 4.Sarandë 5.Shqipëri

72 .03(496.574)

711.4(496.574) (091)

